




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

**RAPORTI VJETOR I 2020 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË
REALIZUAR NGA
MINISTRIA E KULTURËS**

1.Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me
mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

- Për vitin 2020 Ministria e Kulturës ka konsultuar vetëm një akt i cili u miratua me VKM nr. 583, datë 27.07.2020. Ky proces rezultoi i frytshëm dhe mjaft produktiv në cilësinë e draftimit të projektvendimit. Gjithashtu, Konsultimi Publik (KP) kontribuoi në pranimin e produktit final duke qenë se shumica e komenteve/sugjerimeve të grupeve të interesit u mor parasysh.



- Sfidat dhe Mundësitë:

- COVID-19 ishte shkaktari kryesor i pezullimit dhe shtyrjes së përgatitjes dhe procedimit për draftimin e akteve për vitin 2020 e për rrjedhojë solli dhe pezullimin e procesit të KP. Po, ashtu, COVID-19 ende vazhdon të jetë pengues në realizimin e duhur të procesit (në një shkallë më të ulët);
- Ndonëse takimi i drejtpërdrejtë me grupet e interesit gjatë procesit të KP është vështirësuar pasi grumbullimet në masë janë të ndaluara (për shkak të COVID-19), si dhe vetë pasiguria që kanë pjesëmarrësit nga risku i infektimit me virus, megjithatë format e tjera të komunikimit digjital (ZOOM/Microsoft Teams, etj.), por dhe marrja e të gjithave masave (nga institucioni organizues i takimeve/realizimit të procesit të KP) për të krijuar kushtet e duhura për sigurinë dhe mospërhapjen e COVID-19, kanë luajtur dhe luajnë rol thelbësor për vazhdimësinë dhe ecurinë e procesit të KP, duke mundësuar marrjen e komenteve/rekomandimeve/sugjerimeve të pjesëmarrësve/grupeve të interesit.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

- 28 akte të miratuara për vitin 2020: 19 akte të miratuara nga PPAP 2020 dhe 9 akte të miratuara jashtë PPAP-së.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

- 2 akte iu nënshtruan KP, ku 1 akt u miratua, ndërkohë akti tjetër pritet të miratohet për vitin 2021.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

- Nuk ka pasur.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfshirjet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

- Nuk ka pasur asnjë akt.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

- Një akt i konsultuar dhe i miratuar për vitin 2020 ishte Projektvendim;
- Akti tjetër i konsultuar por jo i miratuar për vitin 2020 ishte Projektligj.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

- Po është përmirësuar dukshëm. Përmirësimi vihet re sa i takon: dhënies prioritet procesit të konsultimit publik, më shumë interes dhe besim në procesin e konsultimit publik nga grupet e interesit; megjithëse duhet thënë që ka dhe subjekte të caktuara të cilët ndonëse japin kontributin e tyre me komente/rekomandime/sugjerime në draftimin e projektaktit, ende mbeten skeptik mbi këtë proces, ku faktor kryesor i skepticizmit dhe kritikizmit të procesit të KP luan dhe mos përfshirja sa duhet e komenteve/sugjerimeve/rekomandimeve të tyre në projektakt.

- Përmirësim vihet re gjithashtu dhe në shtimin e akteve për t'ia nënshtruar KP: kështu, në ndryshim nga viti 2019 ku vetëm një akt iu nënshtrua procesit të KP, për vitin 2020 ishin parashikuar 5 akte për t'iu nënshtruar KP, ndonëse procesi nuk u realizua pasi u pezullua vazhdimi i ecurisë për miratimin e këtyre akteve për shkak të COVID-19.

2.2. Metodat e konsultimit

2.2.1. *Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

- Drejtpërdrejtë gjatë takimit publik;
- Regjistri Elektronik;
- Me email info@kultura.gov.al;
- Me postë në adresën Rruga "Aleksandër Moisiu", nr. 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë.

2.2.2. *Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

- Drejtpërdrejtë gjatë takimit publik.

2.2.3. *A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

- Nuk ka realizuar KP në fazat e hershme të hartimit të projektakteve.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. *Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

- Dy konsultime: Periudha më e gjatë e KP mbi 30 ditë, ndërsa periudha më e shkurtër 25 ditë.

2.3.2. *Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

- Mesatarja e KP ~30 ditë.

2.3.3. *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

- Po është përmirësuar pavarësisht pengesave të shfaqura nga COVID-19.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 *Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?*

- 5 aktorë të jashtëm (persona juridikë/fizikë).

2.4.2 *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

- Organizata me karakter universal si QTB-së, ICOMOS-it dhe ICCROM-it, Universitete, Institute, Akademi, Agjenci me fokus veprimtarie të lidhur me projektaktin që paraqitet për konsultim publik, akademikë dhe studiues të fushës, si dhe qytetarë/individë të thjeshtë duke qenë se efektet e aktit në zbatim shtrihen dhe prekin interesat e tyre.

2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet hapura të realizuar për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

- 15 palë të përfshira (këtu përfshihet numri i personave fizikë/juridikë dhe individë, si grupe dhe jo numri total i pjesëmarrësve, pasi vetëm grupi i një prej personave juridikë, ka pasur pjesëmarrës më shumë se një person përfaqësues në procesin e KP, ashtu sikurse edhe nga grupi i individëve psh., ka pasur një numër të lartë pjesëmarrësish dhe jo vetëm një person i vetëm.)

2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

- 12 persona juridikë. Sa i përket numrit të personave (individëve) pjesëmarrës dhe/ose kontribuues në procesin e KP është i papërcaktueshëm saktë duke qenë se akti i nënshtruar KP ishte i hapur jo vetëm për ekspertë apo specialistë të fushës por edhe për qytetarë të thjeshtë (banorë të zonës) duke qenë se akti sjell efekte dhe në komunitetin e tyre.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

- Po, ka përmirësime.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

- Nisur vetëm për aktin e miratuar për vitin 2020 i cili u konsultua me grupet e interesit, numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjatë KP, ishte (përafërsisht): 25.

2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

- Nga gjithë komentet/rekomandimet e marra, u morën plotësisht në konsideratë sugjerimet e kontribuuesve/u dhanë sqarimet e nevojshme për 24 komente/rekomandime/propozime, dhe u refuzua vetëm një sugjerim.

2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

- Priorja është të merren në konsideratë sa më shumë prej komenteve/sugjerimeve të grupeve të interesit për aq sa mund të përfshihen në projektakt. Gjithashtu, tendenca është zgjerimi dhe përfshirja e sa më shumë subjekte që hyjnë tek grupet e interesit për projektaktin që draftohet.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuarnë bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

- Nuk ka pasur.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

- Nuk ka publikuar.

2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

- Nuk kemi informacion.

2.7.Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

- Vetëvlerësimi 8 pikë pasi: projektakti/et u publikuan/ohen në regjistrin elektronik për KP, është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit; janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre, në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara.

3.Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen*(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

- Vështirësi në realizimin e procesit të KP për shkak të COVID-19;
- Ngurrimi i subjekteve/grupeve të interesit për të marrë pjesë në konsultime (takime të dpd) për arsye të infektimit me COVID-19;
- Deri tani nuk ka pasur asnjë reagim nga grupet e interesit/qytetarë në regjistrin elektronik të KP – nevojitet më shumë informimin mbi ekzistencën dhe efektshmërinë e regjistrit elektronik i cili mundëson dhënien e komenteve/sugjerimeve/rekomandimeve direkt aty, duke shmangur kështu takimet/grumbullimet në këtë kohë pandemie.